



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 590, datë 26.11.2020

**PËR
MIRATIMIN E “PLANIT STRATEGJIK TË KOMUNIKIMIT PËR SISTEMIN
GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 91 dhe 97, pika 1 shkronja “c” të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, si dhe në përputhje me Ligjin Nr.7756, datë 11.10.1993, “Për Shtypin”, i ndryshuar, Ligjin Nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, i ndryshuar, dhe me Ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë e përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Kryetari, anëtari i Këshillit i caktuar për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, gjyqtarët e medias, nëpunësit për marrëdhëniet me publikun dhe mediat, me marrjen e masave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet njësia mbështetëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet me publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE

NAUREDA LEAGAMI





PLANI STRATEGJIK I KOMUNIKIMIT PËR SISTEMIN GJYQËSOR KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i angazhuar për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, si një ndër objektivat e tij kryesorë. Nëpërmjet këtij plani strategjik komunikimi, synohet përcaktimi i bazave për përmirësimin marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve. Transparenca, ndershmëria, llogaridhënia dhe besueshmëria janë parimet udhëheqëse dhe komunikimi do të kryhet në mënyrë profesionale, në çdo kohë.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
www.klgj.al



TABELA E PËRMBAJTJES

Deklaratë e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Rreth Këshillit të Lartë Gjyqësor

- Deklarata e Vizionit
- Deklarata e Misionit
- Vlerat thelbësore të gjyqësorit

Plani Strategjik i Komunikimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Qëllimet e Komunikimit

Monitorimi dhe Shqyrtimi

Alokimi i burimeve

Parimet kryesore të komunikimit të gjyqësorit

- Roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor në zbatimin e parimeve të komunikimit
- Roli i Gjyqtarit të Medias në zbatimin e parimeve të komunikimit
- Roli i Nëpunësit për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun (NMMP) në zbatimin e parimeve të komunikimit
- Roli i bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës në zbatimin e parimeve të komunikimit
- Roli i faqeve të internetit të gjykatave
- Roli i mediave sociale

Sfidat dhe Mundësitë

Publiku i synuar dhe mesazhet kryesore

Mënyrat dhe mjetet e komunikimit

Lidhja A: Model i Udhëzuesit Standard të Shtypit

Lidhja B: Model i Njoftimit për Shtyp

DEKLARATË E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Ligji Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë” parashikon krijimin e pozicioneve të reja në gjykata, duke përfshirë disa pozicione kryesore për komunikimin me median dhe publikun. Këshilli i Lartë Gjyqësor, përmes Anëtarit të tij të Caktuar për Kryerjen e Detyrave në Lidhje me Marrëdhëniet me Publikun, Gjyqtarëve të Medias dhe Nëpunësve për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun (NMMP) në gjykata, kanë për detyrë të sigurojnë që informacioni që i ofrohet publikut të jetë i saktë dhe në kohë, duke përdorur një sërë mjetesh, përfshirë edhe faqet e internetit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) tashmë ka filluar punën e rëndësishme për të përmirësuar marrëdhëniet me median dhe publikun brenda gjyqësorit, përmes caktimit të Gjyqtarëve të Medias në 8 gjykata që mbulojnë juridiksionet e apelit të Shkodrës, Vlorës, Korçës, Tiranës, Durrësit, Gjirokastrës, juridiksionin e posaçëm administrativ dhe juridiksionin e posaçëm për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Gjithashtu, KLGJ ka parashikuar NMMP në disa prej gjykatave kryesore në vend: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Lartë. Përmes përkrahjes së Projektit të USAID “Drejtësi për të Gjithë”, KLGJ ka qenë në gjendje të sigurojë edhe në Gjykatën e Rretheve Gjyqësore Durrës dhe Lezhë nga një NMMP të përkushtuar.

Një faqe e re interneti e Këshillit është tashmë funksionale, me informacion të përditësuar në lidhje me Këshillin, anëtarët e tij, vendimet dhe dokumentacionin përkatës. Këshilli i Lartë Gjyqësor është angazhuar për një proces të vazhdueshëm komunikimi me partnerët e mediave dhe ka zhvilluar takimet e para me gazetarët përfaqësues të mediave, si dhe ka planifikuar për të zhvilluar takime të tjera në vijim.

Këshilli, për të garantuar përmirësimin e aksesit, të kuptuarit dhe besimit në gjykatat e Shqipërisë, ka hartuar këtë “Plan Strategjik të Komunikimit” për Informimin e Medias dhe Publikut, dokument i cili do të orientojë veprimtarinë e gjyqësorit shqiptar. Ky plan komunikimi, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kombëtare, miratohet pas konsultimit me gjykatat, për vetë rëndësinë e tij. Për hartimin e këtij plani, Këshilli është ndihmuar nga Projekti i USAID “Drejtësi për të Gjithë”.

Ekziston një angazhim i qartë për Gjyqtarët e Medias dhe NMMP për të përballuar sfidën e marrëdhënieve me publikun dhe mediat që mbulojnë gjykatat në Shqipëri. Tashmë ka nisur një qasje e re, me njerëzit e përkushtuar për të siguruar informacion të saktë për median dhe publikun, në funksion të përmirësimit të transparencës së veprimtarisë së gjyqësorit.

Si pjesë e këtij plani, KLGJ dhe gjykatat janë të përkushtuar të punësojnë profesionistë me kualifikim të lartë për të shërbyer si NMMP dhe të garantojnë që ata janë të trajnuar dhe vënë në zbatim praktikat më të mira për dhënien e informacionit dhe bashkëveprimin me median dhe publikun në mënyrë sa më efikase. NMMP do të punojnë me Gjyqtarët e Medias për të siguruar që

veprimet e gjykatave dhe procedurat e shërbimet gjyqësore janë të kuptueshme dhe lehtësisht të disponueshme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i gatshëm të bëjë gjithçka që mundet, për të siguruar që gjyqësori shqiptar të funksionojë me transparencë të plotë dhe është i përkushtuar për arritjen e standardeve më të larta të përgjegjshmërisë publike në komunikimin me median dhe publikun.

RRETH KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Në vitin 2016 Shqipëria ndërmori reforma gjithëpërfshirëse kushtetuese dhe legjislative, të hartuara për të forcuar integritetin dhe qeverisjen e gjyqësorit, përfshirë ato institucionale, me krijimin e institucioneve të reja: Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP), Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (KED) dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD).

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi vetëqeverisës i gjyqësorit, i themeluar në dhjetor 2018. Ndër funksionet e tij të shumta, Këshilli realizon planifikimin e nevojshëm në emër të të gjithë gjyqësorit. Ky plan strategjik i komunikimit është një element thelbësor i kësaj detyre të Këshillit.

Anëtarët e KLGJ janë përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe përparësive, si edhe për sigurimin e burimeve të nevojshme për arritjen e tyre.

VIZIONI

Drejtësia në Shqipëri do të arrihet kur të gjithë qytetarët janë të sigurt se ata do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në bazë të ligjit, nga një sistem gjyqësor që është i pavarur, etik dhe efikas.

MISIONI

Misioni i KLGJ është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që kërkon përsosmëri dhe që meriton besimin e publikut.

VLERAT THELBËSORE TË GJYQËSORIT

Pavarësia - KLGJ dhe Gjykatat janë të angazhuara për ndërtimin e një gjyqësori që funksionon në pavarësi të plotë, pa ndikim dhe i përkushtuar ndaj sundimit të ligjit.

Integriteti - KLGJ dhe Gjykatat janë të përkushtuara për ndërtimin e një gjyqësori të ndershëm që funksionon sipas parimeve më të larta morale dhe etike dhe gjithmonë përpiqet të sigurojë drejtësinë.

Profesionalizmi - KLGJ dhe Gjykatat janë të angazhuara për ndërtimin e një gjyqësori, anëtarët e të cilit kanë të gjitha aftësitë e nevojshme për të kryer mirë rolet e tyre.

Paanshmëria - KLGJ dhe Gjykatat janë të përkushtuara që të trajtojnë të gjithë shtetasit si të barabartë para ligjit.

Përgjegjësia - KLGJ dhe Gjykatat janë të përkushtuara të sigurojnë që të gjithë anëtarët e gjyqësorit janë të gatshëm të pranojnë përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre.

Përtej vlerave thelbësore të KLGJ dhe Gjykatave, vendimmarrja e përditshme e gjyqësorit është e drejtuar nga këto parime dhe të drejta të rëndësishme, si dhe:

Aksesi, Efektiviteti, Efikasiteti, Barazia, Dinjiteti, Drejtësia, Besueshmëria, Respekti, Përgjegjësia dhe Transparenca

QËLLIMET E KOMUNIKIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hartuar një Plan Strategjik shumë të plotë për Sistemin Gjyqësor, i cili përfshin pesë objektiva thelbësorë. Objektivi 5 adreson në mënyrë specifike komunikimin.

Objektivi 5 : Hartimi i Strategjive të Efektshme për Komunikimin e Jashtëm

Një ndër objektivat kryesorë të Këshillit është forcimi i marrëdhënieve midis gjyqësorit, partnerëve tanë dhe publikut, duke hartuar dhe zbatuar një plan strategjik të komunikimit. Ne jemi të përkushtuar të veprojmë në mënyrë transparente, duke siguruar që media dhe publiku të jenë plotësisht të informuar për ndryshimet në gjyqësor.

Objektivat specifike përfshijnë:

- 5.1 Ofrimi dhe zbatimi i mënyrave novatore dhe të përshtatshme për palët e interesit, në veçanti përmes sistemeve online, për rritjen e bashkëpunimit me to të KLGJ, personelit administrativ dhe gjykatave;
- 5.2 Marrja e një roli aktiv për të ndikuar në politikat publike dhe për të nxitur ndryshimet e duhura specifike, lidhur me mënyrën se si pushtetet e tjera ndërveprojnë me KLGJ, për planifikimin në sistemin gjyqësor;
- 5.3 Vendorsja e një strategjie komunikimi për të siguruar marrëdhënie transparente, proaktive dhe informuese të medias dhe publikut;
- 5.4 Publikimi në kohë i vendimeve gjyqësore në portal/façen e internetit të KLGJ.

Monitorimi dhe Shqyrtimi

Këshilli i Lartë Gjyqësor do të përdorë një larmi mjetesh kërkimore, duke përfshirë shqyrtimin e reagimeve të drejtpërdrejta nga përdoruesit e gjykatave, publiku i gjerë, grupet e interesit, monitorimin e mediave, kryerjen e sondazheve rreth perceptimit publik, analizimin e të dhënave/statistikave të faqeve të internetit, me qëllim:

- ❖ Rritjen e ndërgjegjësimit për vizionin, misionin, qëllimet strategjike dhe veprimet e KLGJ;

- ❖ Rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe të pjesëmarrjes së publikut në përcaktimin e përparësive të komunikimit të gjyqësorit;
- ❖ Rritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe të marrëdhënieve proaktive me mediat;
- ❖ Rritjen e koordinimit dhe efikasitetit të komunikimit të brendshëm.

Alokimi i burimeve

Këshilli i Lartë Gjyqësor do të përdorë treguesit kryesorë për të menaxhuar performancën dhe shpërndarjen e burimeve. Metodot e zgjedhura për shpërndarjen e burimeve do të përshtaten në mënyrë të tillë që të korrespondojnë me nevojat e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të gjykatave.

Burimet njerëzore, financiare, teknike dhe institucionale të nevojshme për zbatimin e strategjive të komunikimit dhe arritjen e qëllimeve strategjike do të shpërndahen brenda kornizës së përcaktuar në këtë plan strategjik të komunikimit. Proceset e përmirësuara të koordinimit të komunikimit të brendshëm, përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe bashkëpunimi me organizatat homologe në sistemin e drejtësisë, do t'i mundësojnë sistemit gjyqësor shqiptar të menaxhojë burimet në mënyrë më të efektshme dhe më efikase dhe të realizojë misionin e tij thelbësor, në përputhje me vlerat thelbësore të gjyqësorit.

PARIMET KRYESORE TË KOMUNIKIMIT TË GJYQËSORIT

Komunikimi i gjyqësorit me publikun kryhet bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe në respektim të së drejtës së informimit, mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

Aksesi - Publiku ka të drejtë të vëzhgojë procedurat gjyqësore dhe të kuptojë se çfarë ndodh në gjykatë, si funksionojnë gjykatat dhe si menaxhohet sistemi gjyqësor. Një nga detyrat e NMMP, me mbështetjen e Gjyqtarit të Medias, është të sigurojë informacion dhe akses në masën më të madhe të mundshme, siç përcaktohet në ligj.

Komunikimet Profesionale – Gjykata duhet të komunikojë profesionalisht, menjëherë dhe me mirësjellje, përmes NMMP, ose nëse do të jetë e nevojshme, përmes Gjyqtarit të Medias ose Kryetarit të Gjykatës.

Besueshmëria - Të gjithë gjyqtarët, Gjyqtari i Medias, NMMP dhe personeli i gjykatës duhet të jenë të sqertë me publikun dhe mediat, të japin sa më shumë informacion, siç përcaktohet në ligj, dhe nuk duhet të japin informacion sensitiv, konfidencial, apo që cenon veprimtarinë gjyqësore. Nëse ndodh gabimisht që të jepet informacion i pasaktë, ai duhet të korrigjohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Përgjegjësia - Gjykatat japin drejtësi në emër të Republikës dhe janë në shërbim të publikut. Gjyqtarët, personeli i gjykatës dhe personeli i KLGJ duhet të marrin përgjegjësinë për administrimin e gjykatave dhe burimeve të tyre në mënyrë profesionale. Gjykatat do të synojnë vazhdimisht për përsosmëri në trajtimin e dosjeve gjyqësore, përpunimin e çështjeve, mbajtjen e seancave dhe të sigurojnë që mjediset e gjykatës dhe informacionet gjyqësore të jenë lehtësisht të aksesueshme. Nëse ndeshin vështirësi, ato do të përpiqen të trajtojnë çështjen sa më shpejtë të jetë e mundur dhe me përgjegjësi.

ROLI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NË ZBATIMIN E PARIMEVE TË KOMUNIKIMIT

Aksesi

- ❖ Faqja e internetit e KLGJ do të përmbajë informacion të plotë dhe informacione kontakti për KLGJ dhe gjykatat, përfshirë informacionin e kontaktit të zyrës së shtypit, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit dhe lidhjet në të gjitha faqet e internetit të gjykatave shqiptare;
- ❖ Faqja e internetit e KLGJ duhet të jetë lehtësisht e përdorshme dhe të përfshijë informacion për Këshillin, veprimtarinë dhe vendimmarrjen e tij, njoftime, programin e transparencës, legjislacion, informacion për gjykatat, kontaktet e Gjyqtarëve të Medias dhe të Nëpunësve për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, informacion mbi të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, informacion mbi strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave në veçanti, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, tarifatat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik.
- ❖ Gjykatat do të jenë në gjendje të krijojnë faqet e tyre të internetit të veçanta, ndërsa KLGJ duhet të sigurojë një model të unifikuar, në mënyrë që të gjitha faqet e internetit të gjykatave të kenë një pamje të ngjashme e të jenë lehtësisht të identifikueshme për publikun.
- ❖ Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.

Profesionalizmi

Këshilli i Gjykatës cakton nëpunësin civil gjyqësor për marrëdhëniet me median dhe publikun (NMMP) si koordinador, në përputhje me ligjin për kompetencat e koordinаторit për të drejtën e informimit.

KLGGJ do të përshkruajë detyrat dhe përgjegjësitë e NMMP, të cilat do të përfshijnë:

- Kthimin e përgjigjeve lidhur me kërkesat e paraqitura nga publiku dhe media, në kuadër të së drejtës së informimit, gjithmonë nën mbikëqyrjen e Gjyqtarit të Medias, duke respektuar afatet e parashikuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Mbikëqyrjen e përmbajtjes së faqes së internetit, për të siguruar që publiku të informohet në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore, si edhe për veprimet gjyqësore, oraret, shërbimet, apo informacione të tjera;
- Hartimin e njoftimeve për shtyp në rastet që kanë interes të veçantë për publikun; kur oraret e gjykatës ose shërbimet ndryshojnë; kur një gjyqtar i ri caktohet në detyrë në mënyrë të përhershme në gjykatë, ose një gjyqtar del në pension; kur shtohet ndonjë program ose shërbim; kur ka ndonjë aktivitet në të cilin publiku mund të marrë pjesë; kur shtohet një mjet i ri komunikimi (postë elektronike, faqe interneti, ose llogari e mediave sociale);
- Ofrimin e shpjegimeve ndaj medias dhe publikut për të kuptuar procedurat gjyqësore dhe funksionimin e gjykatave.

Besueshmëria

KLGGJ ka caktuar Gjyqtarët e Medias për çdo juridiksion apeli, bazuar në interesin e tyre për pozicionin, të kuptuarit e tyre për rolin e medias dhe të komunikimit të tyre me gjykatat, aftësitë e tyre personale dhe të komunikimit publik.

KLGGJ bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për të siguruar trajnimin e anëtarëve të Këshillit, të gjyqtarëve të medias, të administratës së Këshillit dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun.

Përgjegjësia

KLGGJ do të sigurojë fonde për gjykatat për pagat e NMMP, të paktën në gjykatat më të mëdha, si edhe për mjetet e nevojshme për informimin e publikut. Buxheti i KLGGJ do të publikohet në faqen e tij të internetit.

KLGGJ do të qartësojë rolin e zyrës së shtypit të KLGGJ, si dhe rolin e Gjyqtarëve të Medias dhe NMMP, për median dhe publikun.

KLGGJ do të hartojë dhe përditësojë një listë kontaktesh, në mënyrë që të gjithë NMMP të kenë mundësinë të komunikojnë nëpërmjet postës elektronike me njëri-tjetrin dhe me Gjyqtarët e Medias, nëse kanë nevojë për informacion apo këshilla, synojnë të organizojnë një aktivitet, apo kërkojnë kontributin e të tjerëve.

KLGJ do të hartojë udhëzues në lidhje me prezencën e përfaqësuesve të medias në gjykata, rregullat e zbatueshme gjatë pjesëmarrjes së tyre në seancat gjyqësore, përgjegjësitë e tyre në lidhje me raportimin e veprimtarive gjyqësore, si dhe të drejtat e tyre për t'u njohur me procedurat dhe dokumentet gjyqësore.

ROLI I GJYQTARIT TË MEDIAS NË ZBATIMIN E PARIMEVE TË KOMUNIKIMIT

Aksesi

- ❖ Informacioni mbi Gjyqtarët e Medias publikohet në faqen e internetit të KLGJ dhe të gjykatave;
- ❖ Gjyqtarët e Medias do të shpjegojnë proceset gjyqësore dhe ligjin e zbatueshëm në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme;
- ❖ Gjyqtarët e Medias do të ilustrojnë vlerat kryesore të transparencës, profesionalizmit, besueshmërisë dhe llogaridhënies;
- ❖ Gjyqtarët e Medias do të takohen me përfaqësuesit e medias të paktën një herë në vit, për të dëgjuar problematikat e tyre, të diskutojnë për gjetjen e zgjidhjeve për to, për lehtësimin e raportimit të saktë të veprimtarisë së gjykatave dhe të informimit sa më të saktë e të shpejtë të publikut;
- ❖ Gjyqtarët e Medias do të jenë gjithmonë të hapur për komente dhe sugjerime për përmirësimin e punës së tyre.

Profesionalizmi

- ❖ KLGJ cakton Gjyqtarët e Medias në konsultim me kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët e tjerë, për të garantuar që ata gëzojnë besimin e kolegëve, si edhe për cilësitë e tyre etike, aftësitë personale dhe aftësitë komunikuese;
- ❖ KLGJ harton dhe përditëson detyrat Gjyqtarëve të Medias, në mënyrë që ata të vlerësojnë pozicionin e tyre dhe të jenë në lartësinë e detyrës, të ndërgjegjshëm për pritshmëritë e medias dhe publikut ndaj tyre.

Besueshmëria

- ❖ Gjyqtarët e Medias japin informacion të saktë dhe të plotë, sipas përcaktimeve të ligjit, duke përdorur një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme;
- ❖ Gjyqtarët e Medias marrin të gjitha masat për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke mos lejuar përpunimin e të dhënave sensitive e konfidenciale dhe të informacionit që cenon veprimtarinë gjyqësore;
- ❖ Gjyqtarët e Medias do të jenë transparentë për veprimtarinë e sistemit gjyqësor, do të ruajnë standardet më të larta të profesionalizmit, do të jenë të besueshëm në marrëdhëniet e tyre me gjyqtarët, personelin e gjykatës, përfaqësuesit e medias dhe publikun.

Përgjegjësia

- ❖ Gjyqtarët e Medias e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet NMMP, si rregull. NMMP duhet të marrin gjithmonë kërkesën fillestare nga përfaqësuesit e medias në adresat e tyre të postës elektronike apo numrat e telefonit, të bërë publikë. Gjyqtarët e Medias do të jenë të disponueshëm për NMMP sapo të jetë e mundur, në mënyrë që ata të ndihmojnë në kthimin e përgjigjes, nëse krijohet një situatë urgjente;
- ❖ Gjyqtarët e Medias nuk përfshihen në zgjidhjen e një çështjeje me interes të veçantë publik, por do të jenë në dispozicion për të shpjeguar procedurat për median dhe publikun. Përfaqësuesve të medias u bëhet e qartë që gjyqtarët nuk mund të bëjnë deklarata publike në media për çështjet në shqyrtim;
- ❖ Në rastet e çështjeve me interes të veçantë publik, Gjyqtari i Medias dhe NMMP do të koordinojnë veprimtarinë e tyre ngushtësisht me gjyqtarin e çështjes dhe Kryetarin e Gjykatës, sa i përket marrëdhënieve me median, përfshirë: njoftimin nëse do të ketë vende të rezervuara, nëse do të lejohen kamerat, nëse mund të përdoren telefonat për komunikim dhe postime në mediat sociale nga salla e gjyqit, midis çështjeve të tjera;
- ❖ Gjyqtarët e Medias do të sigurojnë sjelljen me përgjegjshmëri të gjykatave ndaj publikut të cilit i shërbejnë, duke pranuar që kur gjykatat nuk veprojnë në mënyrën më të mirë të mundshme, të marrin masat për të adresuar çdo mangësi, sa më parë që të jetë e mundur.

ROLI I NMMP NË ZBATIMIN E PARIMEVE TË KOMUNIKIMIT

Aksesi

- ❖ NMMP do të jenë burimi kryesor i informacionit për median dhe publikun, gjithmonë nën mbikëqyrjen e Gjyqtarit të Medias;
- ❖ Pas miratimit nga Gjyqtari i Medias, NMMP do të sigurojnë që i gjithë informacioni i kërkuar të jepet sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë të plotë, të saktë dhe profesionale;
- ❖ Kur ka zhvillime të lidhura me veprimtarinë e gjykatës, me interes për publikun, NMMP do të bëjnë njoftime për të informuar median dhe publikun. Në këto njoftime duhet përdorur një gjuhë lehtësisht e kuptueshme nga publiku dhe në përmbajtje duhet të përfshihen informacione më të hollësishme dhe të dhëna kontakti për ata që mund të kenë pyetje të tjera shtesë;
- ❖ NMMP do të bashkëpunojnë me personelin teknik për të siguruar që faqja e internetit e gjykatës është e lehtë për t'u përdorur dhe e konceptuar në mënyrë të tillë, që të mbajë parasysh kërkesat e publikut. Në të duhet të jetë i disponueshëm një seksion i pyetjeve që bëhen me shpesh dhe funksioni i kërkimit nëpërmjet fjalëve kyç, si edhe informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara;

- ❖ NMMP duhet të përdorin edhe platformat e mediave sociale për të informuar publikun. Në këtë mënyrë, mund të përcillet në kohë informacioni drejtpërdrejt te publiku dhe përfaqësuesit e mediave. Postimet në mediat sociale nuk duhet të përfshijnë informacione për raste specifike, por duhet të përfshijnë çdo ndryshim të orarit, vendndodhjes, procedurave, apo informacione të tjera, në mënyrë që ata që interesohen për çështje të caktuara, të mund të marrin pjesë në seancat ose të kërkojnë ndihmë gjyqësore, ndërsa në rastet e ndryshimeve, të mund të përshtatin planet e tyre, në përputhje me rrethanat;
- ❖ NMMP do të ndihmojnë për hartimin e një përmbledhjeje të rregullave të gjykatës në lidhje me aksesin e medias dhe publikut, të cilat do të jenë të përfshira në një dokument të vetëm, të thjeshtë, i cili është i disponueshëm në faqen e internetit të gjykatës. Në të përfshihet informacion në lidhje me prezencën e medias dhe kamerave në sallën e gjyqit, sendet dhe veshjet që nuk lejohen në sallën e gjyqit, për respektimin e solemnitetit të gjykatës, udhëzime në lidhje me përdorimin e telefonave celularë në mjediset e gjykatës, si edhe një përmbledhje të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- ❖ NMMP do të punojnë me çdo gjyqtar që gjykon një çështje me interes të veçantë publik, për të lehtësuar sa të jetë e mundur aksesin e medias dhe publikut, por gjithmonë duke respektuar rregullat në lidhje me ruajtjen e rendit dhe solemnitetit në mjediset e gjykatës. Kjo mund të nënkuptojë rezervimin e vendeve të veçanta për median dhe të tjera për publikun, duke siguruar që mikrofonat dhe qendrat e zërit në sallën e gjyqit janë funksionale dhe me volum të mjaftueshëm;
- ❖ NMMP do u komunikojnë medias përmbledhje të vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes të veçantë publik;
- ❖ Çdo NMMP do të hartojë një plan strategjik konkret për gjykatën ku ushtron detyrën, në bashkëpunim me Kryetarin dhe Kancelarin e Gjykatës, si edhe me Gjyqtarin e Medias të atij juridiksioni. Ky plan do të përfshijë kohën dhe vendin e caktuar ku NMMP, Gjyqtari i Medias ose Kryetari i Gjykatës në raste me interes të veçantë publik, do të jenë të disponueshëm për të dëgjuar shqetësimet e publikut dhe adresimin e tyre. Disponueshmëria do të mundësohet të paktën një orë në muaj;
- ❖ NMMP duhet të jenë në dispozicion për trajtimin e kërkesave nga publiku. Ata do të afishojnë në vende të dukshme në mjediset e gjykatës dhe në faqen e internetit të gjykatës informacionet e tyre të kontaktit, numrin e telefonit, adresën e postës elektronike, orarin kur publiku mund të hyjë për të marrë informacion, si edhe të dhënat për platformat e mediave sociale që përdor gjykata.

Profesionalizmi

- ❖ NMMP u përgjigjen kërkesave të medias dhe publikut sa më shpejt dhe saktë që të jetë e mundur, në mënyrë që shmangen pasaktësitë, keqinformimi dhe keqinterpretimi dhe publiku të ketë një pamje të qartë të veprimtarisë gjyqësore. Çdo informacion i pasaktë do të korrigjohet sa më shpejt të jetë e mundur;



- ❖ NMMP zhvillojnë takime periodike me përfaqësuesit e medias që ushtrojnë veprimtarinë në juridiksionin e gjykatës, për të sqaruar procedurat gjyqësore dhe legjislacionin në lidhje me të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe respektimin e konfidencialitetit. Kur është e mundur, të paktën disa prej këtyre takimeve drejtohen nga Gjyqtari i Medias;
- ❖ NMMP duhet të hartojnë përmbledhje të thjeshta, lehtësisht të kuptueshme nga publiku, në lidhje me proceset gjyqësore, të tilla si: mënyra se si paraqitet një çështje civile, si një çështje penale kalon që nga faza e arrestimit e deri në gjykim, kur mund të merret vendimi i arsyetuar, apo informacione të tjera, me interes për publikun. Këto përmbledhje të shkurtra, 1-2 faqe, publikohen në faqen e internetit të gjykatës dhe postohen në mediat sociale që përdor gjykata.

Besueshmëria

- ❖ NMMP sigurojnë informacion të saktë dhe të plotë, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të kuptueshme;
- ❖ NMMP sigurojnë që informacioni që publikon gjykata në internet dhe rrjetet sociale është i përditësuar;
- ❖ NMMP nuk japin informacion që përmban të dhëna sensitive e konfidenciale, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.

Përgjegjësia

- ❖ NMMP janë të vetëdijshëm që të dhënat e performancës së gjykatës janë thelbësore për një publik të informuar, që ka besim në sistemin gjyqësor. Të dhënat i ofrohen publikut në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ❖ NMMP janë përgjegjës për ofrimin e informacionit publik, si atë që shpërndahet nga vetë gjykata, ashtu edhe atë që jepet në përgjigje të kërkesave nga media dhe publiku. Në raste të veçanta, në vend të NMMP, publikut mund t'i drejtohet Gjyqtari i Medias ose Kryetari i Gjykatës, për të dhënë shpjegime mbi sistemin ligjor dhe procedurat gjyqësore, kur këto nuk janë lehtësisht të kuptueshme;
- ❖ NMMP duhet të hartojnë një plan komunikimi në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për përcjelljen sa më shpejt të informacionit te palët e interesuara dhe publiku.

ROLI I BASHKËPUNIMIT ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS NË ZBATIMIN E PARIMEVE TË KOMUNIKIMIT

Aksesi

- ❖ KLGJ bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës (ShM) për të siguruar trajnimin e anëtarëve të Këshillit, të gjyqtarëve të medias, të administratës së Këshillit dhe të nëpunësve

civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun. Në mënyrë të veçantë, trajnimi duhet të përfshijë:

- Rolin e transparencës në krijimin e besimit të publikut te sistemi gjyqësor;
- Rëndësinë e një përgjigjeje të shpejtë, para se lajmi të përhapet gjerësisht;
- Rëndësinë e gjykatave të hapura dhe që garantojnë akses;
- Rolin e mediave sociale në ditët e sotme;
- Rëndësinë e strategjisë së aksesit në publik.

Profesionalizmi

- ❖ KLGJ, duke punuar ngushtë me ShM, do të organizojë një takim, të paktën një herë në vit, për të gjithë NMMP, që përfshin trajnimin, krijimin e rrjetit ndërlidhës midis tyre dhe shkëmbimin e ideve;
- ❖ KLGJ do të koordinojë përpjekjet me ShM për të organizuar të paktën një konferencë në vit për Gjyqtarët e Medias, duke u përqendruar në aftësitë që duhen shfaqur gjatë intervistimit, kryerjen e intervistave simuluese, qëndrimin që duhet mbajtur gjatë përcjelljes së mesazheve, etj.;
- ❖ KLGJ do të koordinojë përpjekjet me ShM për të organizuar trajnime për përfaqësuesit e medias për raportimin me saktësi dhe profesionalizëm të aktiviteteve gjyqësore, si edhe përfitim të ideve prej tyre për përmirësimin e punës së gjyqësorit në marrëdhëniet me median dhe publikun;
- ❖ Trajnimet përfshijnë seanca për përgjegjshmërinë dhe etikën profesionale;
- ❖ Në varësi të fondeve në dispozicion, KLGJ do të koordinojë përpjekjet me ShM për të përfituar prej përvojës së vendeve të tjera ku praktika e gjyqtarëve të medias është e konsoliduar.

ROLI I FAQEVE TË INTERNETIT TË GJYKATAVE

Aksesi

- ❖ Gjykatat marrin të gjitha masat që informacioni në faqet e tyre të internetit të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme;
- ❖ Faqet e internetit të gjykatave duhet të jenë:
 - Lehtësisht të përdorshme jo vetëm nga avokatët, por edhe nga publiku i gjerë;
 - Të aksesueshme edhe nëpërmjet telefonave celularë;
 - Të aksesueshme nëpërmjet shfletuesve të ndryshëm të faqeve të internetit (browser), si Chrome, Explorer, Firefox, etj.
- ❖ Faqet e internetit të gjykatave duhet të përfshijnë:
 - Informacion për të udhëzuar qytetarët që nuk përfaqësohen nga një avokat, se si duhet t'i drejtohen gjykatës për të nisur një proces gjyqësor;

- Informacion lidhur me aksesin në gjykatë, përfshirë aksesin për të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe;
- Informacion lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti, subjektet përfitues të ndihmës juridike dytësore, procedurën e depozitimit dhe shqyrtimit të kërkesës nga gjykata;
- Informacion lidhur me tarifat gjyqësore;
- Informacion lidhur me procedurën e depozitimit dhe shqyrtimit të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore;
- Informacion lidhur me afatin dhe mënyrën se si mund të ushtrohet e drejta e ankimit/rekursit ndaj një vendimi gjyqësor;
- Përgjigjet për ankesat;
- Formularët që mund të plotësohen dhe dorëzohen në internet (online).

Profesionalizmi

- ❖ Faqet e internetit duhet të përqendrohen në nevojat dhe pyetjet e përdorueseve të gjykatës;
- ❖ Faqet e internetit duhet të jenë të organizuara në mënyrë të tillë që të jetë e lehtë për të gjetur informacionet që kërkohen më shpesh, d.m.th. të kenë një funksion të mirë kërkimi, për të gjetur vendimet gjyqësore, shortin e çështjeve gjyqësore, kalendarin e seancave gjyqësore, kontaktet e gjykatës, programin e transparencës. si dhe informacione të tjera me interes për publikun.

Besueshmëria

- ❖ Faqet e internetit duhet të jenë të përditësuara në mënyrë të vazhdueshme dhe informacioni në përmbajtje të tyre duhet të jetë i saktë.

Përgjegjësia

- ❖ Faqet e internetit duhet të përmbajnë rregullat që duhet të zbatohen nga publiku, përfshirë përfaqësuesit e medias, në mënyrë që ata të jenë të informuar paraprakisht, p.sh. nëse do të mund të kryhen fotografime, regjistrime, filmime, apo veprime të tjera, në mjediset e gjykatës;
- ❖ Faqet e internetit do të shërbejnë edhe si mundësi komunikimi të ndërsjellë e të vazhdueshëm me publikun, ku kërkesat, komentet, apo pyetjet e publikut do të përdoren si instrumente matës për cilësinë e ofrimit të informacionit.

ROLI I MEDIAVE SOCIALE

Aksesi

- ❖ Platformat e mediave sociale do të përdoren për të dhënë informacion në mënyrë të shpejtë edhe për ata që mund të mos kenë kompjuter ose akses në një faqe në internet, kur këto të fundit mund të jenë bllokuar për shkak të problemeve teknike, ose në raste emergjente;
- ❖ Informacioni i transmetuar nëpërmjet mediave sociale do të përfshijë postimin në kohën e duhur në lidhje me ndryshimet e mundshme të orarit, sallave, vendndodhjes, procedurave, apo informacione të tjera me rëndësi për publikun;
- ❖ Përdorimi i platformave të mediave sociale do të jetë pjesë e një përpjekjeje të përgjithshme për të transmetuar informacionin edhe për ata që nuk janë të njohur me gjykatat dhe mënyrën e funksionimit të tyre. Për shembull, videot në YouTube që ofrojnë informacione mbi gjykatën mund të jenë të dobishme. Nëse një gjykatë ka burime për të bërë një video të tillë, ajo mund të vendoset në faqen e gjykatës në YouTube, në faqen e saj të internetit dhe lidhja (link) duhet të vendoset edhe në mediat e tjera sociale.

Profesionalizmi

- ❖ Mediat sociale do të përdoren në mënyrë profesionale për të transmetuar informacione tek publiku dhe grupet e interesit të gjykatës, në kohën e duhur.

Besueshmëria

- ❖ Postimet në mediat sociale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara, sipas nevojës.

Përgjegjësia

- ❖ Mediat sociale, si edhe faqet e internetit të gjykatës, duhet të përdoren për të përcjellë informacione mbi mënyrën e funksionimit të gjykatës, si dhe mënyrën e menaxhimit të burimeve.

SFIDAT DHE MUNDËSITË

Sfidat kryesore

- ❖ Qëndrimet e publikut;
- ❖ Skepticizmi;
- ❖ Mungesa e financimit të duhur;
- ❖ Mungesat e personelit;
- ❖ Mungesat e sallave të gjyqit, që sjell edhe mungesën e solemnitetit dhe të regjistrimeve të seancave gjyqësore;
- ❖ Informimi i personave që nuk përfaqësohen nga avokat, nuk kanë akses në internet, apo kategorive të tjera;

- ❖ Aksesit në ambientet e gjykatave që nuk janë të pajisura me lehtësira për të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe;
- ❖ Aksesit në gjykatat që janë në një distancë të largët nga vendbanimet e palëve;
- ❖ Ndryshimi paraqet gjithmonë sfida.

Mundësitë Kryesore

- ❖ Legjislacioni i ri është padyshim një “pikë kthese” e qartë për gjyqësorin, përfshirë rolin e Gjyqtarëve të Medias dhe NMMP dhe raportin e veçantë midis tyre;
- ❖ Ekzistojnë tashmë përvoja pozitive në disa gjykata, risi që mund të shërbejnë si modele edhe për gjykatat e tjera dhe për Gjyqtarët e Medias;
- ❖ Maksimizimi i përdorimit të mundësive që ofron teknologjia, në kushtet kur pritshmëritë janë që informacioni të përcillet sa më shpejt. Teknologjia mundëson edhe abonimin e personave të interesuar për të marrë komunikimet periodike nga gjykatat, ku mund të bëjnë pjesë përveç medias, edhe kolegët e gjykatave të tjera, pedagogët e fakulteteve të drejtësisë, avokatët, noterët, përmbaruesit, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.;
- ❖ Mbështetja e partnerëve, SHBA, BE, Këshilli i Europës, Ambasada Hollandeze, BIRN, etj., që janë shumë të interesuar të ndihmojnë për ta bërë të suksesshme këtë qasje të re.

PUBLIKU I SYNUAR DHE MESAZHET KRYESORE

Publiku i gjerë

- ❖ Sistemi gjyqësor duhet të gëzojë besimin e publikut dhe t’i ofrojë atij siguri. Sistemi gjyqësor duhet ta arrijë këtë nëpërmjet punës së tij intensive, të përditshme;
- ❖ Sistemi gjyqësor i shërben interesit publik, të gjithë personave, pa dallime gjinore, etnike, racore, gjuhësore, fetare, bindje politike, gjendje ekonomike, etj.;
- ❖ Sistemi gjyqësor flet me zë të qartë dhe të qëndrueshëm dhe dëgjon me kujdes zërin e publikut;
- ❖ Sistemi gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm garanton sundimin e shtetit të së drejtës, duke i shërbyer interesit publik;
- ❖ Këshilli i Lartë Gjyqësor është i përkushtuar që sistemi gjyqësor dhe shërbimet që ai ofron, të jenë në lartësinë e duhur, për të realizuar pritshmëritë e publikut.

Media

- ❖ Media dhe sistemi gjyqësor i shërbejnë interesit publik në lartësinë e duhur kur ekziston respekti dhe bashkëpunimi i ndërsjellë, duke qenë të vetëdijshëm për rolet e tyre të dallueshme në një demokraci;

- ❖ Ekzistojnë shumë faktorë që përcaktojnë cilësinë e demokracisë, por vetëm dy, prej të cilëve varet mbijetesa e demokracisë: një shtyp i lirë dhe një gjyqësor i pavarur;
- ❖ Mediat janë partnerë thelbësorë në sigurimin e informacionit në kohë, të saktë dhe të plotë në lidhje me sistemin gjyqësor, duke ruajtur pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e gjyqësorit;
- ❖ Sistemi gjyqësor është i përkushtuar për marrëdhënie proaktive me mediat dhe për ndërtimin e marrëdhënieve të mira profesionale me përfaqësuesit e tyre. Besimi i publikut te gjyqësori varet nga perceptimi që publiku ka për të, perceptim i cili në masë të madhe përçohet prej medias. Përmes komunikimit të strukturuar, të vazhdueshëm dhe proaktiv me mediat, publiku mund të informohet më mirë për punën e sistemit gjyqësor, si edhe të jetë i vetëdijshëm dhe mirëkuptues ndaj vetëkufizimeve që gjyqtarët i imponojnë vetes në jetën e tyre të përditshme;
- ❖ Marrëdhënia me median dhe besimi reciprok ndërtohen hap pas hapi. Lidhjet vendosen gradualisht, jo vetëm atëherë kur media ka nevojë për informacion, apo kur gjyqësori ka nevojë për të përcjellë informacion.

Shoqëria Civile

- ❖ Këshilli i Lartë Gjyqësor inkurajon komunikimin e ndërsjellë midis shoqërisë civile dhe gjyqësorit, për të promovuar vlerat themelore demokratike të pavarësisë gjyqësore dhe demokracisë pjesëmarrëse;
- ❖ Është e rëndësishme të krijohet një bazë e të dhënave me aktorët e ndryshëm të interesit që veprojnë brenda territorit juridiksional të çdo gjykate, me qëllim që me ta të komunikohet për çështje që janë me interes për komunitetin që përfaqësojnë, të tilla si: shoqatat e mbrojtjes së të miturve, shoqatat e mbrojtjes së grave, shoqatat mjedisore, etj.;
- ❖ Sistemi gjyqësor siguron informacion të plotë, të saktë dhe në kohë, që i lejon organizatat e shoqërisë civile të marrin vendime të informuara dhe nga ana tjetër, gjyqësori informohet nga reagimet e shoqërisë civile;
- ❖ Pavarësia e Gjyqësorit është një gur themeli i shtetit të së drejtës dhe jetike për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Sektori i Biznesit

- ❖ Një Gjyqësor i pavarur që i përmbahet besnikërisht sundimit të ligjit dhe nuk është i ndikuar nga ndikimi politik ose presioni publik është shenjë dalluese e një demokracie të qëndrueshme dhe kontribuon gjithashtu në stabilitetin ekonomik;
- ❖ Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit krijon besim në sigurinë dhe parashikueshmërinë e transaksioneve ekonomike.

Organizatat homologe

- ❖ KLGJ bashkëpunon me organizatat homologe që ndajnë qëllime të përbashkëta, adopton përvojat më pozitive të tyre, për të ruajtur dhe mbështetur pavarësinë dhe integritetin gjyqësor.

Mënyrat dhe mjetet e komunikimit

❖ Faqe Interneti (Interaktive)	<i>përditësim ditor</i>
❖ Udhëzues për Gjykatat (Printim/Online)	<i>përditësim vjetor</i>
❖ Njoftime publike (Printim/Elektronike)	<i>sipas rastit</i>
❖ Formular/broshura/fletëpalosje informuese	<i>sipas rastit</i>
❖ Ngjarje të veçanta (pjesëtarë të caktuar të publikut)	<i>sipas rastit</i>
❖ Ngjarje të jashtëzakonshme (situata emergjente)	<i>sipas rastit</i>
❖ Posta elektronike (email) (publiku i gjerë)	<i>përditësim ditor</i>
❖ Rrjetet sociale (Facebook/Twitter/YouTube)	<i>përditësim ditor</i>
❖ Konferenca Gjyqtar-Media	<i>një herë në vit</i>
❖ Telefonata (publiku i gjerë)	<i>sipas rastit</i>
❖ Trajnime (Gjyqtar/NMMP /Media)	<i>një herë në vit</i>
❖ Takime me grupe të interesit	<i>sipas rastit</i>
❖ Seminare edukative (pjesëtarë të caktuar të publikut)	<i>përditësim periodik</i>
❖ Aktivitete “Gjykata e Hapur”, gjatë Javës së Drejtësisë, 4-10 maj	<i>një herë në vit</i>
❖ Tryeza të rrumbullakëta (Sektori i biznesit)	<i>sipas rastit</i>
❖ Sondazhe të opinionit publik	<i>një herë në vit</i>
❖ Intervista në media/Konferenca shtypi	<i>sipas rastit</i>
❖ Foto/Video/ Kronika në mediat	<i>sipas rastit</i>
❖ Buletini elektronik	<i>përditësim periodik</i>

LIDHJA A: MODEL I UDHËZUESIT STANDARD TË SHTYPIT

GJYKATA

TITULLI

[Nëntitulli - me më shumë detaje (nëse nevojitet, sipas rastit)]

Datë _____

Kontakt :

[emri i NMMP, numri i telefonit, adresa e postës elektronike (email)]

ÇFARË: Ngjarja / Iniciativa

KU: Vendndodhja. Të jetë sa më specifike, sa më e qartë.

KUR: Data / Ora.

KUSH (PJESËMARRËSIT): Renditni të gjithë personat kyç që do të marrin pjesë, në bazë të pozicionit.

Shënoni me ngjyrë të theksuar (**bold**) emrat e pjesëmarrësve që ka të ngjarë të jenë me interes për median/publikun.

Dy deri në tre fjali në lidhje me ngjarjen/iniciativën, shpjegoni se si dhe cilat janë pritshmëritë/çfarë interesi do të ketë për median/publikun.

Siguroni çdo të dhënë që është në dispozicion dhe lidhje (link) për më shumë informacion paraprak, në faqen e internetit të gjykatës nëse është e mundur, ndërsa burime të tjera mund të shtohen më pas.

Sipas rastit, mund të njoftoni ndonjë rregull të veçantë për median/publikun, p.sh. nëse duhet të konfirmojnë pjesëmarrjen (RSVP), nëse ka ndonjë kufizim në lidhje me vendosjen/përdorimin e regjistruarëve/kamerave, a do të ketë mundësi që gjyqtarët/pjesëmarrësit të intervistohen, etj.

MBYLLJA/SHËNIME TË FUNDIT:

“Për më shumë informacion, shihni faqen e internetit të gjykatës dhe/ose na ndiqni në Facebook/Twitter/YouTube ...”

LIDHJA B: MODEL I NJOFTIMIT PËR SHTYP

GJYKATA

NJOFTIM PËR SHTYP

TITULLI

Datë _____

Kontakt :

[emri i NMMP, numri i telefonit, adresa e postës elektronike (email)]

Filloni me fjali të theksuara, deklarative duke përdorur fjalë ndërvepruese dhe duke deklaruar se çfarë është arritur/realizuar/përfunduar/filluar. Përfundoni paragrafin me një shpjegim të mëtjshëm të ngjarjes/ndodhjes/arritjes.

Paragrafi i dytë duhet të jetë një citim nga Gjyqtari i Medias, Kryetari i Gjykatës ose Kancelari, sipas rastit.

Vendosja e një fotografie krahas tekstit të njoftimit, mund të merret në konsideratë, sipas rastit.

Nëse është e nevojshme, një paragraf i tretë mund të përfshihet me më shumë detaje, pa u zgjatur shumë, pasi mund të jetë më e përshtatshme që përfaqësuesit e medias të komunikojnë me NMMP për të marrë informacion më specifik, sipas interesave të tyre. Njoftimi për shtyp është vetëm për të tërhequr vëmendjen e tyre se diçka e veçantë po ndodh.

Paragrafi i fundit siguron të dhëna ose lidhje (link) për më shumë informacion paraprak, në faqen e internetit të gjykatës nëse është e mundur, me më shumë informacion mbi temën.

MBYLLJA/SHËNIME TË FUNDIT:

“Për më shumë informacion, shihni faqen e internetit të gjykatës dhe/ose na ndiqni në Facebook/Twitter/YouTube ...”